



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Udhëzues Pune i Zyrës Administrative në lidhje me të paraburgosurit

Ankesat

Miratuar nga:	Administratorja, Dhomat e Specializuara të Kosovës
Data e miratimit:	23 shtator 2020
Data e hyrjes në fuqi:	23 shtator 2020
Zëvendëson:	KSC-BD-11
Numri:	KSC-BD-11-Rev1

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	2
NENI 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI.....	2
NENI 2	PËRKUFIZIME.....	3
NENI 3	ZBATIMI	3
NENI 4	PARASHTRIMI I NJË ANKESE OSE KËRKESE PËR RISHIKIM	3
NENI 5	LLOGARITJA E AFATEVE	4
KREU II	PROCEDURA E PARASHTRIMIT TË ANKESAVE DHE PROCEDURA RISHIKUESE.....	4
NENI 6	ANKESË DREJTUAR SHEFIT TË PARABURGIMIT	4
NENI 7	RISHIKIMI ADMINISTRATIV PREJ ADMINISTRATORIT	5
NENI 8	ANKESË E PARASHTRUAR DREJTPËRSËDREJTI ADMINISTRATORIT	5
NENI 9	RISHIKIMI GJYQËSOR NGA PANELI KOMPETENT	6
NENI 10	AFATET PËR PARASHTRIME	6
NENI 11	ANKESAT E MËTEJME	7
KREU III	DISPOZITË PËRFUNDIMTARE	7
NENI 12	NDRYSHIMET.....	7

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Në përputhje me rregullën 63 të Rregullores së Paraburgimit, Administratorja ka miratuar këtë Udhëzues Pune për Ankesat (“Udhëzuesi i Punës”) që përcakton procesin përmes të cilit të paraburgosurit mund të parashetrojnë ankesë në lidhje me trajtimin dhe/ose kushtet e paraburgimit të tyre në objektin e paraburgimit.
2. Fushëveprimi i këtij Udhëzuesi Pune nuk është më i gjerë se ai i Rregullores së Paraburgimit.
3. Ky Udhëzues Pune nuk ndikon në të drejtën e të paraburgosurve për të apeluar ligjshmërinë e arrestimit dhe të kushteve të paraburgimit të tyre dhe që për një apel të tillë paneli kompetent të vendosë brenda një kohe të shkurtër, në bazë të nenit 41(2) të Ligjit dhe Rregullores së Procedurës dhe të Provave.
4. Ky Udhëzues Pune nuk ndikon në të drejtën e të paraburgosurve për të komunikuar lirisht dhe në konfidencialitet të plotë me përfaqësuesit e KNKK-së sikurse përcaktohet hollësisht në Rregulloren e Paraburgimit dhe në Udhëzuesin e Punës për Vizitat dhe Komunikimet miratuar në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit.
5. Ky Udhëzues Pune nuk zbatohet në procedimet disiplinore që trajtohen konkretisht në Udhëzuesin e Punës për Disiplinën miratuar në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit.

Neni 2 Përkufizime

Krahas përkufizimeve të rregullës 2 të Rregullores së Paraburgimit, më poshtë vijojnë këto përkufizime:

Zyra e administrimit	Zyra për administrim në Njësinë e Paraburgimit të Zyrës Administrative;
Ankesë	Parashtrim me shkrim i një të paraburgosuri në përputhje me këtë Udhëzues Pune lidhur me trajtimin e vet dhe/ose kushtet e paraburgimit në objektin e paraburgimit, duke përfshirë edhe çfarëdo shkelje të pretenduar të Rregullores së Paraburgimit, ose udhëzuesve të punës apo udhëzimeve të miratuara ose lëshuara në bazë të rregullës 4 të Rregullores së Paraburgimit;
Kërkesë për rishikim administrativ	Parashtrim me shkrim i një të paraburgosuri në përputhje me këtë Udhëzues Pune ku Administratorit i kërkohet të rishikojë një vendim në lidhje me një ankesë;
Kërkesë për rishikim gjyqësor	Parashtrim me shkrim i një të paraburgosuri në përputhje me këtë Udhëzues Pune ku panelit kompetent i kërkohet të rishikojë një vendim në lidhje me një ankesë;
Kërkesë për rishikim	Kërkesë për rishikim administrativ ose gjyqësor.

Neni 3 Zbatimi

Ky Udhëzues Pune interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Ligjin, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe Rregulloren e Paraburgimit.

Neni 4 Parashtrimi i një ankesë ose kërkesë për rishikim

1. I paraburgosuri parashtron ankesë ose kërkesë për rishikim në përputhje me këtë Udhëzues Pune. I paraburgosuri mund të parashtojë ankesë ose kërkesë për rishikim në një gjuhë që e kupton.
2. Për këtë qëllim, në mjedise të caktuara të objektit të paraburgimit gjenden formularë standardë në të tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara. Në qoftë se gjuha amtare e të paraburgosurit nuk është ndër tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, i paraburgosuri merr të përkthyer formularin standard në një gjuhë që e kupton.
3. I paraburgosuri i parashtron ankesë ose kërkesë për rishikim autoritetit përkatës nëpërmjet zyrës së administrimit, duke ia dorëzuar dokumentin drejtpërsëdrejti një oficeri të paraburgimit, ose në një mënyrë tjetër të përcaktuar për këtë qëllim.
4. As oficerët e paraburgimit, as persona të tjerë nuk censurojnë ankesat dhe kërkesat për rishikim të cilat i përcillen pa vonesë zyrës së administrimit.

5. Në ankesë ose kërkesë për rishikim shënohet qartë data e marrjes së tyre prej zyrës së administrimit. Me marrjen e ankesës ose kërkesës për rishikim, zyra e administrimit ia kalon atë shefit të paraburgimit ose Administratorit, sipas rastit, pa vonesë dhe në përputhje me procedurat dhe udhëzimet përkatëse.
6. Zyra e administrimit mban një regjistër të të gjitha ankesave, kërkesave për rishikim dhe vendimeve të tjera përkatëse, përfshirë edhe përkthimet përkatëse.

Neni 5 Llogaritja e afateve

1. Afatet në lidhje me këtë Udhëzues Pune llogariten në ditë kalendarike.
2. Llogaritja e afatit fillon nga dita e parë e punës pas datës së ngjarjes përkatëse, p.sh., datës së marrjes në formë të shkruar të një vendimi, ankese apo kërkesë për rishikim, sipas rastit.
3. Nëse dita e fundit e afatit është në fundjavë ose në një ditë pushimi zyrtar, atëherë si dita e fundit e afatit llogaritet dita vijuese e punës.
4. Llogaritja e afatit fillon vetëm pasi i paraburgosuri të ketë marrë përkthimin me shkrim të vendimit përkatës të shefit të paraburgimit ose Administratorit, sipas rastit, në një gjuhë që e kupton.
5. Autoriteti vendimmarrës në lidhje me ankesën ose kërkesën për rishikim, me nismën e vet ose pasi i tregohen arsye bindëse, mund të pranojë si të vlefshme ankesën ose kërkesën për rishikim të parashtruar nga një i paraburgosur pas kalimit të afatit përkatës.

KREU II PROCEDURA E PARASHTRIMIT TË ANKESAVE DHE PROCEDURA RISHIKUESE

Neni 6 Ankesë drejtuar shefit të paraburgimit

1. I paraburgosuri ka të drejtë t'i paraqesë shefit të paraburgimit ankesë lidhur me trajtimin e vet dhe/ose kushtet e paraburgimit në objektin e paraburgimit. Ndër kushtet e paraburgimit përfshihen edhe kufizimet me karakter të përgjithshëm që zbatohen për të gjithë të paraburgosurit. Ankesa paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga dita kur trajtimi ose kushtet për të cilat i paraburgosuri ankohet, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti mbi të.
2. I paraburgosuri e parashtron ankesën në përputhje me nenin 4 të këtij Udhëzuesi Pune. Shefi i paraburgimit konfirmon me shkrim dhe pa vonesë marrjen e ankesës.
3. Shefi i paraburgimit jep një vendim me shkrim në lidhje me ankesën e të paraburgosurit, më së voni brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e ankesës, me përjashtim të rrethanave që përligjin një kohë më të gjatë për marrjen e vendimit. Në raste të tilla, shefi i paraburgimit njofton të paraburgosurin për sa më sipër dhe e mban të informuar për hapat që ndërmerren.
4. Në vendimin lidhur me ankesën e të paraburgosurit, shefi i paraburgimit jep arsyet me shkrim dhe në një gjuhë që i paraburgosuri e kupton.
5. Shefi i paraburgimit informon të paraburgosurin se ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishikim administrativ të vendimit të shefit të paraburgimit në përputhje me nenin 7 të Këtij Udhëzuesi Pune. Njoftimi për të paraburgosurin lidhur me të drejtën e tij për të kërkuar rishikim administrativ, përmban edhe afatin përkatës për parashtrimin e kërkesës.

Neni 7 Rishikimi administrativ prej Administratorit

1. I paraburgosuri ka të drejtë të kërkojë rishikimin e vendimit të shefit të paraburgimit në lidhje me një ankesë, duke i parashtruar Administratorit një kërkesë për rishikim administrativ brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të shefit të paraburgimit.
2. I paraburgosuri parashtron kërkesë për rishikim administrativ sipas këtij neni në përputhje me nenin 4 të këtij Udhëzuesi Pune. Shefi i paraburgimit i dërgon Administratorit të gjithë informacionin përkatës në lidhje me kërkesën për rishikim administrativ.
3. Administratori konfirmon me shkrim dhe pa vonesë marrjen e kërkesës për rishikim administrativ.
4. Administratori nxjerr vendim me shkrim në lidhje me kërkesën e të paraburgosurit për rishikim administrativ, më së voni brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga marrja e kërkesës, me përjashtim të rrethanave që përligjin një kohë më të gjatë për rishikimin e vendimit. Në raste të tilla, Administratori njofton të paraburgosurin për sa më sipër dhe e mban të informuar për hapat që ndërmerren.
5. Gjatë rishikimit, Administratori merr në shqyrtim të gjithë materialin përkatës dhe kërkon mendimet e të gjithë personave ose subjekteve përkatëse brenda Njesisë së Paraburgimit ose burgut. Gjatë kësaj periudhe të paraburgosurit i lejohet të komunikojë lirisht dhe pa censurë me Administratorin në lidhje me këtë çështje.
6. Në vendimin mbi kërkesën për rishikim administrativ, Administratori jep arsyet me shkrim dhe në një gjuhë që i paraburgosuri e kupton.
7. Administratori informon të paraburgosurin se ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishikim gjyqësor të vendimit të Administratorit, në përputhje me nenin 9 të këtij Udhëzuesi Pune. Njoftimi për të paraburgosurin lidhur me të drejtën e tij për të kërkuar rishikim gjyqësor përmban edhe afatin përkatës për parashtrimin e kërkesës.
8. Kërkesa e të paraburgosurit për rishikim administrativ nuk e pezullon zbatimin e vendimit të shefit të paraburgimit, përveçse kur Administratori vendos ndryshe. Vendimi mbetet në fuqi gjatë periudhës së rishikimit deri kur Administratori të nxjerrë një vendim me shkrim.

Neni 8 Ankesë e parashtruar drejtpërsëdrejti Administratorit

1. I paraburgosuri ka të drejtë t'i parashtrojë ankesë drejtpërsëdrejti Administratorit lidhur me sjelljen e shefit të paraburgimit brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga dita kur sjellja për të cilën i paraburgosuri ankohet ka ndikuar drejtpërsëdrejti mbi të, përfshirë edhe rastin kur shefi i paraburgimit nuk ka nxjerrë një vendim të arsyetuar në përputhje me nenin 6.3 të këtij Udhëzuesi Pune.
2. Nëse Administratori nxjerr vendimin e parë me shkrim lidhur me trajtimin dhe/ose kushtet e paraburgimit për një të paraburgosur, sidomos nëse vendimi është për mbikëqyrjen e qelisë së të paraburgosurit me video, për veçim, për kufizimin e vizitave dhe komunikimeve, për qeli të përbashkëta për një periudhë më të gjatë se shtatë (7) ditë, ose për pezullimin e pjesshëm ose tërësor të Rregullores së Paraburgimit, i paraburgosuri mund t'i parashtrojë ankesë drejtpërsëdrejti Administratorit kundër këtij vendimi, ku i kërkon rishikimin e vendimit, brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit.
3. I paraburgosuri i parashtron Administratorit një ankesë të drejtpërdrejtë sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, në përputhje me nenin 4 të këtij Udhëzuesi Pune. Administratori konfirmon me shkrim dhe pa vonesë marrjen e ankesës së drejtpërdrejtë.

4. Neni 7.4 deri në nenin 7.8 të këtij Udhëzuesi Pune zbatohen *mutatis mutandis* për ankesat e drejtpërdrejta, të parashtruara sipas këtij neni.

Neni 9 Rishikimi gjyqësor nga paneli kompetent

1. Një i paraburgosur ka të drejtë të kërkojë rishikim gjyqësor të vendimit të Administratorit sipas nenit 7 dhe nenit 8 të këtij Udhëzuesi Pune, duke parashtruar një kërkesë për rishikim gjyqësor brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit.
2. I paraburgosuri parashtron kërkesën për rishikim gjyqësor sipas këtij neni, në përputhje me nenin 4 të këtij Udhëzuesi Pune. Administratori konfirmon me shkrim dhe pa vonesë marrjen e kërkesave për rishikim gjyqësor.
3. Me të marrë kërkesën për rishikim gjyqësor, Administratori ia parashtron atë pa vonesë panelit kompetent në përputhje me udhëzuesin përkatës të punës për parashtrimet para Dhomave të Specializuara. Mbrojtësi i të paraburgosurit njoftohet në lidhje me këtë parashtrim. Në qoftë se është më shumë se një panel kompetent, Administratori ia referon pa vonesë çështjen Kryetarit të Dhomave të Specializuara për vendim caktimi në përputhje me nenet 25 dhe 33 të Ligjit.
4. Administratori i dërgon panelit kompetent të gjithë informacionin përkatës në përputhje me udhëzuesin përkatës të punës për parashtrimet para Dhomave të Specializuara. Administratori mund t'i paraqesë panelit kompetent argumente lidhur me aspekte që ndikojnë në kryerjen e detyrave të veta në përputhje me rregullën 23(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.
5. Kërkesa për rishikim gjyqësor të vendimit të Administratorit sipas këtij nenin nuk pezullon zbatimin e atij vendimi, përveçse kur paneli kompetent urdhëron ndryshe.
6. Vendimi i panelit kompetent është i formës së prerë.

Neni 10 Afatet për parashtrime

Në tabelën e mëposhtme jepen afatet për parashtrimin e ankesave dhe kërkesave për rishikim pranë autoriteteve përkatëse:

Lloji	Afati
Ankesë drejtuar shefit të paraburgimit në lidhje me trajtimin e të paraburgosurit dhe/ose kushtet e paraburgimit (Neni 6.1)	Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga dita kur trajtimi ose kushtet për të cilat i paraburgosuri ankohet kanë ndikuar drejtpërsëdrejti mbi të paraburgosurin
Kërkesë për rishikim administrativ (Neni 7.1)	Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e vendimit me shkrim të shefit të paraburgimit
Ankesë e parashtruar drejtpërsëdrejti Administratorit në lidhje me sjelljen e shefit të paraburgimit (Neni 8.1)	Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga dita kur sjellja për të cilën i paraburgosuri ankohet ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë mbi të paraburgosurin
Ankesë e parashtruar drejtpërsëdrejti Administratorit ku kërkohet rishikimi i një vendimi të marrë nga vetë Administratori (Neni 8.2)	Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit

Kërkesë për rishikim gjyqësor (Neni 9.1)	Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit në përgjigje të një ankese ose kërkesë për rishikim administrativ të parashtruar drejtpërsëdrejti Administratorit
--	---

Neni 11 Ankesat e mëtejme

1. Vendimi i formës së prerë në lidhje me një ankesë nuk e ndalon të paraburgosurin të parashtrojë sërish ankesën mbi bazën e informacionit të ri ose të zbuluar rishtazi i cili mund të kishte qenë faktor vendimtar në marrjen e vendimit dhe nuk mund të ishte zbuluar më herët përmes ushtrimit të zellit të duhur.
2. Në një rast të tillë, parashtrimi i të paraburgosurit konsiderohet ankesë e re të cilën sipas rastit shefi i paraburgimit, ose Administratori, e trajton në përputhje me këtë Udhëzues Pune.

KREU III DISPOZITË PËRFUNDIMTARE

Neni 12 Ndryshimet

1. Ndryshimet e këtij Udhëzuesi Pune hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit të tyre.
2. Ndryshimet e këtij Udhëzuesi Pune nuk kanë fuqi prapavepruese.

Hagë, Holandë
23 shtator 2020

Dr. Fidelma Donlon
Administratore